



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1058/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kicaj dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Kandidatin për anëtarë të kuvendit Komunal në komunën e Obiliqit Dorent Rushiti nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë dega në komunën e Obiliqit paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021.të Komisionit Qendror të zgjedhjeve (KQZ) Për shpalljen e rezultateve përfundimtare për zgjedhjet Lokale 2021,për Kuvendin Komunal në seancën e Panelit të mbajtur me datë 07.11.2021.mori ketë.

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1058/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Kandidati për anëtarë të kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit Dorent Rushiti, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë dega në Komunën e Obiliqit paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021.të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1058/2021 të paraqitur nga Kandidati për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit Dorent Rushiti, nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli ne Prishtine, dega në Komunën e Obiliqit paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021.të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).për shpalljet e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.për Kuvend Komunal. me të cilën pretendon se , në Komunën e Obiliqit ka mospërputhje të votave dhe manipulim me vota, andaj ka kërkuar që të bëhet rinumërim në vendvotimet 1513E/01D,i njëjti deklaroi se nuk i ka votat e familjare të tije të cilët e kanë votuar mbi 20 anëtar të familjes, kurse i kanë dalur vetëm 4 vota .apeluesi kërkon nga PZAP të rinumërohen të gjitha votat.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga, kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Obiliqit me të cilën kërkon rinumërim të votave në Vendvotimet 1513E/01DF, në komunën e Obiliqit.

Ankesa është e pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tije, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apellesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1058/2021 më datën 07.11.2021



Kryesuesi i Panelit
Zyhdërit Haziri

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.